

NewsLetter 20 Years



THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

OPINION EKONOMIK

Pse duhet të synojmë për Transformim Digjital dhe jo Digjitalizimin

Blokimi, pavarësisht gjithë dobësive që kishte, ishte një kontroll interesant për pulsën e biznesit që operonte nga distanca ose me dyer të mbyllura. Aty ku teknologjia ishte konsideruar si një e bukur e shtrenjtë për dekada, papritmas u pa si një domosdoshmëri.

Diana Xhumari / Tegeria

» Vijnë në faqen 4

PROFIL

KUR NOVATORIZMIN NË TEKNOLOGJI E DREJTON NJË GRUA

Linda Shomo, krijuesja e Easy Pay, tregon se nuk është e lehtë as të drejtosh në një treg ku rregullat i kanë bërë burrat dhe as të edukosh shoqërinë me novacionin e pagesave elektronike.

» Në faqen 5

PASURITË E FSHEHURA

DRAFTI PËR AMNISTINË E KAPITALEVE



**SI DO
KRYHET
DEKLARIMI
VULLNETAR**

Në faqen **2**

AMCHAM LAJME

Amnistia fiskale duhet të konsultohet me grupet e interesit

Dhoma Amerikane e Tregtisë vlerëson se ndryshimet e pritshme fiskale për heqjen e tatimit për biznesin e vogël deri në vitin 2029, si dhe mundësia për përjashtimin e biznesit të

vogël nga TVSH janë nisma pozitive, për rimëkëmbjen e biznesit të dëmtuar nga COVID-19. Përfaqësues të Dhomës Amerikane të Tregtisë thonë se nevojitet një plan afatgjatë 10-vjeçar për shmangien e informalitetit. "Heqja e tatimit ...

Në faqen **3**

COVID 19- ECONOMIC

NEWS

Goditja e shërbimeve nga Covid-19

Më të prekurat hotelet, agjencitë e udhëtimit, baret e restorantet

» Në faqen 7

Drafti për amnistinë e kapitaleve

SI DO KRYHET DEKLARIMI VULLNETAR

Bizneset dhe individët që kanë kapitale të padeklaruara, mund t'i legalizojnë duke paguar tatimin në burim që do të variojë nga **5 deri në 10 për qind, në varësi të kohës së deklarimit.**

Kështu e ka menduar qeveria, të ribëjë aktive pasuritë e fshehura, por duke vendosur disa kriterë për ata që mund të përfitojnë, në draftin i cili akoma nuk ka mbërritur për diskutim në tavolinat e biznesit. Projektligji është për diskutim në tavolinën e Moneyval, që është një mekanizëm kontrollues i Komisionit Evropian. Shqipëria u kthye në mars të këtij viti në listën gri të vendeve që paraqesin rrezik për pastrimin e parave, për shkak të deficensave strategjike të gjetura nga Task Force për Veprim Financiar (FAFT). Për herë të fundit, vendi ynë kishte dalë nga kjo listë në vitin 2015, pas një vlerësimi të përbashkët, i cili merr në analizë një sërë elementesh që nga kuadri rregullator e deri te zbatimi i tyre.

Nga amnistia do të përjashtohen nëpunësit publikë, të cilët brenda 3 viteve të fundit kanë qenë mbajtës të detyrave në hierarkinë e lartë të administratës dhe familjarët e tyre, si dhe të gjithë subjektet që preken nga ligji për goditjen e krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Amnistia pritet të përfshijë legalizimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme me vendndodhje brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ku përfshihen shumica në të holla, monedhë shqiptare apo e huaj, monedhë digjitale, sende me vlerë, ar apo gurë të çmuar, vepra arti, tituj apo instrumente të tregjeve financiare, pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë.



SUBJEKTET PËRFITUESE

Subjekte të këtij ligji janë individët shtetas të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse janë rezidentë tatimorë ose jo në Republikën e Shqipërisë, personat fizikë juridikë, tatimpagues rezidentë në Republikën e Shqipërisë, si dhe individët rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht shtetësisë së tyre;

Subjekte përfituese të këtij ligji janë subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të cilët kanë kryer procesin e deklarimit vullnetar dhe janë pajisur me vërtetimin e përfundimit të procesit të deklarimit të pasurive sipas parashikimeve të këtij ligji.

SUBJEKTET E PËRJASHTUARA

Janë subjekte të përjashtuara nga zbatimi i këtij ligji:

- Subjektet që kanë detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë, në zbatim të nenit 3 të ligjit nr. Nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar", si dhe personat në përbërje të

gjëndjes familjare të tyre, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

- Subjektet të cilët brenda tre viteve të fundit kanë qenë mbajtës të detyrave apo funksioneve sipas përcaktimit të nenit 3 të ligjit nr. Nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar", si dhe personat në përbërje të gjëndjes familjare të tyre, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

- Subjektet e ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë;

- Subjektet sipas përcaktimit të nenit 16, të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.1.2020 "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike";

- Personat e shpallur dhe personat, për të cilët ka filluar procedura e shpalljes, në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit".

SI DO KRYHET PROCEDURA E DEKLARIMIT VULLNETAR TË PASURIVE DHE PASQYRAVE FINANCIARE

1 Subjektet e këtij ligji mund të deklarojnë vullnetarisht pasuritë dhe elementë të pasqyrave financiare, pavarësisht nëse pasuritë, në tërësinë apo pjesë të tyre, janë të padeklaruara apo të pa regjistruara në autoritet kompetente, apo pavarësisht nëse ato ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë;

2 Deklarimi vullnetar i pasurive apo i pasqyrave financiare (më poshtë deklarimi vullnetar) kryhet pranë strukturës përgjegjëse të ngritur në kuadër të këtij ligji pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve apo ndërmjetësve të autorizuar që janë bankat e nivelit të dytë apo institutet financiare, në sportel apo online, nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarimi të paracaktuar (më poshtë formulari i deklarimit vullnetar), formati i të cilit dhe mënyra e procedimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit përgjegjës për financat;

3 Procesi i deklarimit vullnetar fillon me depozitimin e formularit të deklarimit vullnetar përmendur në pikën 2 të këtij neni dhe përfundon me pajisjen e subjektit me vërtetimin përkatës të lëshuar sipas parashikimeve të këtij ligji. Zhvillimi i procedurës dhe organizimi i saj parashikohen në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat;

4 Pasuritë shumta në të holla depozitohen në llogari bankare të bankave të nivelit të dytë, ndërsa pasuritë e tjera, të detyrueshme për t'u regjistruar, ndiqen procedurat kryejnë regjistrimin sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës të fushës.

TATIMI I POSACËM NË BURIM

Në rastet e deklarimit vullnetar të shumave në të holla dhe të depozitimit të tyre në llogaritë bankare, banka mban një tatim të posacëm në burim në vlerën si vijon:

a) 5 për qind të shumës totale të deklaruar për deklarime të kryera në katër muajt e parë

nga hyrja në fuqi e ligjit;
b) 7 për qind të shumës totale të deklaruar për deklarime të kryera në katër muajt e dytë nga hyrja në fuqi e ligjit;

c) 10 për qind të shumës totale të deklaruar për deklarime të kryera në katër muajt e tretë nga hyrja në fuqi e ligjit;

Në rastet e deklarimit vullnetar të pasurive të tjera të deklaruar vullnetarisht pranë njësisë speciale të ngritur në kuadër të këtij ligji, tatim i posaçëm në burim paguhet në vlerën si vijon:

a) 5 për qind të vlerë së deklaruar për deklarime të kryera në katër muajt e parë nga hyrja në fuqi e ligjit;

b) 7 për qind të vlerë së deklaruar për deklarime të kryera në katër muajt e dytë nga hyrja në fuqi e ligjit;

c) 10 për qind të vlerë së deklaruar për deklarime të kryera në katër muajt e tretë nga hyrja në fuqi e ligjit.

Njesia e posaçme e krijuar me këtë ligj, bankat e nivelit të dytë apo institucionet financiare, në cilësinë e ndërmjetësit, transferojnë të ardhurat e mbledhura nga pagesat e tatimit të posaçmë në burim në kuadër të këtij ligji, në llogaritë e thesarit të Ministrisë së Financave.

RIATDHESIM I PASURIVE

Pasuria, përfshirë shumat në të holla, që ndodhet jashtë territorit të RSH, mund të riatdheshohet me pagimin e tatimit në burim sipas parashikimit të nenit 12 të këtij ligji. Pasuritë e riatdheshuara në këtë mënyrë mund të përdoren dhe administrohen lirisht sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës;

Për riatdheshimin e pasurive sipas pikës 1, subjektet e këtij ligji personalisht apo nëpërmjet ndërmjetësve financiarë, plotësojnë formularin për deklarimin vullnetar të pasurive sipas parashikimeve të nenit 8 të këtij ligji dhe e paraqisin këtë deklarim në autoritet përgjegjëse të kufirit, në rast nevojë. Rregullat dhe mënyra e riatdheshimit të pasurive parashikohen në udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për financat;

Deklarimet dhe veprimet e kryera në kuadër të riatdheshimit të pasurive nga ana e subjekteve përfituese sipas këtij ligji, në lidhje me llojin dhe vlerën e pasurisë që deklarohen vullnetarisht në formularin përkatës, nuk mund të shërbejnë si indicie apo provë për ndjekjen apo procedimin penal dhe/ose administrativ të këtyre subjekteve.

EFEKTET E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË DEKLARIMIT VULLNETAR

Individët, personat fizikë dhe personat juridikë, subjekte përfituese sipas parashikimeve të këtij ligji, me pajisjen me vërtetimin e përfundimit të procesit të deklarimit vullnetar, gëzojnë këto tre drejta:

a) të ardhurat pas kryerjes së pagesës së detyrimeve, sipas parashikimeve në këtë ligj, konsiderohen si të ardhura, për të cilat detyrimet tatimore janë paguar në përputhje me legjislacionin shqiptar;

b) përjashtohen nga detyrimi i dhënies së informacionit pranë institucioneve përkatëse administrative në lidhje me kohën, mënyrën e krijimit, mbajtjen apo posedimin e pasurive të deklaruar në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

c) të drejtën e ruajtjes së sekretit, sipas përkufizimit të këtij ligji, për sa i përket ligjësisimit të pasurive të deklaruar dhe deklarimit të emelentëve të pasqyrave financiare, sipas parashikimeve të këtij ligji;

c) Garanci për subjektet, që kanë deklaruar shumat në të holla, për mosdiskriminimin në të ardhmen, në procedurat e përllogaritjes së de-

tyrimeve tatimore;

d) përjashtim nga ndjekja e procedurave hetimore dhe administrative në kuadër të ndëshkimit administrativ në lidhje me pasuritë e deklaruar sipas parashikimeve të këtij ligji, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj;

e) përjashtim nga ndjekja penale dhe procedimi penal në kuadër të ligjit penal të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë për vepra penale në lidhje me pasuritë e deklaruar sipas kushteve dhe parashikimeve të këtij ligji;

dh) Mosvënia e masës së sekuestros apo konfiskimit ndaj pasurive të deklaruar vullnetarisht;

Çdo paqartësi në zbatimin e këtij ligji interpretohet në favor të subjekteve përfituese.

Tatimet e mbajtura në burim për efekt të deklarimit të pasurive nuk konsiderohen shpenzim i zbritshëm për efekte fiskale. Në rastet e deklarimit të elemntëve të pasqyrave financiare të drejtat e subjekteve përfituese, për aq sa të zbatueshme shtrihen edhe te profesionistët e sektorit që kanë certifikuar veprimet e rishikuara. Parashikimet e këtij neni nuk zbatohen ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 6 i këtij ligji.

AmCham: Heqja e tatimit për biznesin e vogël është pozitive, kujdes me informalitetin

AMNISTIA FISKALE DUHET TË KONSULTOHET ME GRUPET E INTERESIT

Dhoma Amerikane e Tregtisë vlerëson se ndryshimet e pritshme fiskale për heqjen e tatimit për biznesin e vogël deri në vitin 2029, si dhe mundësia për përjashtimin e biznesit të vogël nga TVSH-ja janë nisim pozitiv, për rimëkëmbjen e biznesit të dëmtuar nga COVID-19. Përfaqësues të Dhomës Amerikane të Tregtisë thonë se nevojitet një plan afatgjatë 10-vjeçar për shmangien e informalitetit. "Heqja e tatimit mbi fitimin dhe potencialisht edhe TVSH-së për bizneset e vogla në harkun kohor të 10 vjetëve, është një lajm pozitiv për komunitetin e biznesit. Në rastin e biznesit të vogël, heqja e tatimit mbi fitimin i jep mundësinë atij që të formalizohet dhe të deklarojë xhiron reale të tij, pa rrezikuar taksim më të lartë. Ky është në fakt një lajm i mirëpri-



tur për komunitetin e biznesit të vogël që është dëmtuar shumë nga COVID-19. Por duhen përmendur gjithashtu dhe rreziqe potenciale që lidhen me informalitetin, siç është mundësia e fragmentimit të

bizneseve të mesme në biznese më të vogla. Në çdo rast, një plan afatgjatë 10-vjeçar do shtojë sigurinë e bizneseve të vogla apo fillestare për investime afatgjata, pra kjo përbën një zhvillim pozitiv."

Drafti për Amnistinë Fiskale, sipas përfaqësuesve të Dhomës Amerikane të Tregtisë, duhet të garantojë besueshmëri të plotë të komuniteti i biznesit dhe të ketë përcaktime të qarta ligjore, që shmangin çdo përdorim të mundshëm të tij për përfitime të errëta korruptive. "Ne mendojmë që procesi i përgatitjes së ligjit duhet të ndiqet nga tre faktorë të rëndësishëm. Së pari, të sigurohet një konsultim i gjërë publik me grupet e

interesit. Mendimet e tyre duhet të përshihen atje ku është e vlefshme, në mënyrë që drafti të përmirësohet. Së dyti, është kritike që këshillat e Partnerëve Ndërkombëtarë të merren në konsideratë për të shmangur probleme potenciale me vlerësimin e Shqipërisë nga institucionet ndërkombëtare. Së treti, duhet të garantohet shmangia e pastrimit të parave. Fatkeqësisht, Shqipëria bëri hapa prapa këtë vit. MONEYVAL, Komiteti i Ekspertëve në Këshillin e Europës e përfshiu Shqipërinë përsëri në listën gri të pastrimit të parave, pas daljes prej saj në vitin 2015. Është e rëndësishme pra që ligji të rrisë besimin e investitorëve dhe institucioneve partnere ndërkombëtare dhe jo ta ulë atë. Plotësimi i këtyre kriterëve do orientojë dhe vlerësimin tonë për ligjin."




Diana Xhumari
TEGERIA

» Vijn nga faqja 1

...Ne pamë një shpërthim të mënyrave alternative për të porositur praktikisht, në mënyrë gjysmë analoge ose pothuajse digjitale.

Mua më ndodh të jetoj e ndarë midis dy botëve të ndryshme. Njëra, ku së bashku me ekipin tim të shkëlqyer, jemi në pararojë të teknologjisë, duke realizuar indikatorë të performancës që nuk janë te negociueshëm, dhe për pasojë duke sjellë vlera për klientët tanë, dhe nga ana tjetër, duke pritur një përvojë të ngjashme edhe nga shërbimet e përditshme. Dhe e di që nuk jam vetëm.

Unë kam ndjekur me interes lobi-min mbi digjitalizimit në Shqipëri dhe për këtë ka ardhur koha. Por, duke qenë pjesë e kësaj industrie, unë rekomandoj një fazë më të avancuar: Transformimin Digjital. Ne do të kthehemi te "pse"-ja, por së pari le të shohim se çfarë është secila dhe ndryshimi midis tyre.



EKZISTOJNË TRE FAZA QË NJË BIZNES DHE SHOQËRIA I NËNSHTROHET TEKNOLOGJISË:

Shikoni hinkën fotografike që kam krijuar në analogji me hinkën e shitjeve. Digjitalizimi ka të bëjë me konvertimin e të gjitha informacioneve që një kompani përfshin në një format digjital, i cili mund të ruhet, shpërndahet dhe përpunohet. Digjitalizimi ndërtohet mbi këtë dhe strukturon proceset për ta bërë fuqinë punëtore më efikase dhe më pak të prirur për të humbur kohën - i përdor ato të dhëna dhe nxjerr të dhëna të tjera vetë. Ndërkaq, Transformimi Digjital ka të bëjë më shumë me transformim-



PSE duhet të synojmë për TRANSFORMIM DIGJITAL dhe jo Digjitalizimin

in e mënyrës së të bërit biznes, duke e vendosur klientin në qendër dhe duke krijuar fluks të ri të ardhurash ose modele biznesi. Ndërsa digjitalizimi është i detyrueshëm që pjesa tjetër të vazhdojë, dhe fillon të tregojë shenja të kursimit të parave në automatizim dhe efikasitet, Transformimi Digjital është faza e fundit kur një biznes bën para duke përdorur teknologjinë. Mund të jetë ose akronizuar në DT ose DX. Gjithsesi, unë e përdor me vetëdije këtë të fundit, pasi ka të bëjë më shumë me përvojën (X) sesa teknologjinë (T) - teknologjia duhet të jetë e padukshme, duke pushuar në prapavijë dhe duke bërë të mundur që ajo përvojë të jetë plotësisht e qetë dhe e besueshme.

RIKTHEHEMI TEK PSE-JA.

Nëse do të ishit si unë, mbase do të kishit dashur t'i ofronit një trajtim special ekipit ose njerëzve të tjerë të dashur, gjatë bllokimit. Jam përpjekur shumë të gjej një kanal ku të mund ta mbyllja gjithë procesin në një vend të vetëm, pa m'u dashur ta djeg suprizën e marrjes së një dhurate, duke paguar me cash në dorë gjatë dorëzimit, sepse ju e kuptoni, është një dhuratë. Edhe më keq akoma nëse flitet për ndonjë shënim me dorë.

Kishte shumë shpjegime për të gjithë këtë dhe natyrisht ishte një kohë për për-

parësi të tjera, kështu që unë u përpoqa të mos i shikoja me syrin e kritikut profesional, por më duhej vetëm një zgjidhje dhe të vazhdoja më tej me shumë sfida të tjera që kishte kjo periudhë. Si një kompani ku ne punojmë me XR (Realiteti i zgjatur, përfshirë realitetin e shtuar, realitetin virtual dhe realitetin e përzier), ku ju mund të bashkëveproni me produktin dhe shitësin në një dimension krejtësisht të ri, është si një lloj shuplake në fytyrë kur sheh realitetin aktual të tregtisë. Kjo nuk mund të zgjidhet tërësisht vetëm duke shtuar një kanal digjital ose madje duke u bërë një Biznes Digjital përmes Digitalising - është më shumë një mentalitet dhe ndryshim strategjik në zhvillimin e biznesit.

PSE?

1. Teknologjia është një mjet, dhe jo produkti përfundimtar.

Në epokën e vëmendjes dhe ekonomisë që jetojmë, i vetmi vend ku teknologjia në vetvete është një produkt, është për shitësit që shesin vetëm licenca dhe madje as nuk e mbulojnë zbatimin. Çdo gjë tjetër ka të bëjë me produktin që bëhet pjesë e përbërëse e punës dhe e jetës suaj. Digjitalizimi ka të bëjë me teknologjinë në vetvete, por dhe edhe pse automatizon dhe zgjidh problemet, ai nuk merr

parasysh nevojat më fundore të klientit ose e shndërron biznesin në zgjatime të modeleve të tjera ose domein-eve të tjera. Tashmë kemi klientë digjitalë dhe krijimi i kompanive digjitale do të thellojë hendekun midis dy palëve të interesuara në vend, që këta të fundit të shërbejnë të parët ashtu siç synohet me investimin.

2. Integriteti i brendshëm

Deri vite më parë, teknologjia ishte një ndarje e brendshme. Departamentet e Biznesit dhe Teknologjisë ishin qetësuar, duke minimizuar njëri-tjetrin dhe shpërndarja e një produkti do të ishte më shumë menaxhimi i konfliktit mbi përparësitë. Sigurisht, terminologjia e aftësive të vështira nuk ka ndihmuar. Mënyra e re ka të bëjë me përafrimin e tërë organizatës për të punuar së bashku, për qëllimin e përbashkët digjital ose të quajtur "kongruencë digjitale". Edhe terminologjia tani është e shkrirë dhe e paqartë, dhe kuptohet gjerësisht.

3. Kultura e të dhënave

Ndërsa një kulturë e duhur e të dhënave është akoma një utopi, është thelbësore të kuptohet se çfarë dhe pse nevojitet çdo lloj informacioni dhe si matet. Le të themi nëse është kritike të raportosh për një gjendje specifike ose në të ardhmen ndoshta të parashikosh sjelljen e saj, ndjekja e tij nga fillimi do të ishte e domosdoshme. Në Shqipëri, veçanërisht për NVM-të, ne kemi të bëjmë me Shkrimet e të Dhënave, kështu që ne dimë të lexojmë të dhënat dhe më vonë të krijojmë një kulturë të vendim-marrjes të drejtuar nga të dhënat.

4. Të jesh mbështetës dhe i shkathët

Bizneset e shëndetshme janë të shkëlqyera në testimin, dëgjimin dhe lëshimin e produkteve që klientët e tyre i duan, dhe nuk merren me pjesën tjetër. Instalimi i teknologjisë së re dhe përdorimi i saj thjesht për të mbledhur të dhëna dhe për të mbyllur ciklin e shitjes nuk do të jetë i qëndrueshëm për një kohë të gjatë. Konsumatori po ndryshon shpejt - ata janë duke përdorur teknologji të përsosur që evoluon vazhdimisht. Ata po bëhen gjithnjë e më të kujdeshëm për atë që konsumojnë dhe ku e konsumojnë atë.

Po jemi vonë në digjitalizim! Por bekimi i të qenit vonë në këtë pjesë është se nuk keni pse të bëni gabimet e të tjerëve, as të keni barrën e edukimit të konsumatorëve se si funksionon. Duke punuar me kompani të madhësive të ndryshme dhe vende nga të pesë kontinentet, pra kultura dhe marrëdhënie shumë të ndryshme me teknologjinë, unë kam vërejtur rëndësinë e kontekstit lokal edhe në teknologji. Shqipëria ka një popullsi të re dhe një potencial ende të pasfrytëzuar për turizëm. Ajo duhet të shërbejë për një audiencë tipike që kërkon përvojë. Le të digjitalizojmë duke synuar të bashkohemi me bandën DX, në vend që të krijojmë një trashëgimi që do të na duhet ta hedhim dhe ta ribëjmë brenda disa viteve.



Linda Shomo, krijuesja e EasyPay,

tregon se nuk është e lehtë as të drejtosh në një treg ku rregullat i kanë bërë burrat dhe as të edukosh shoqërinë me novacionin e pagesave elektronike. Por në fund ia ka dalë që ta bëjë EasyPay lider në treg dhe të rishkruajë rregullat.



Kur novatorizmin në teknologji e drejton një grua

1 - LINDA, SI ËSHTË TË DREJTOSH NJË KOMPANI NOVATORE NË FUSHËN E DIGJITALIZIMIT ? E VËSHTIRË, SFIDUESE?

Të drejtosh një kompani novatore siç është EasyPay është me shumë siguri sfiduese, edhe kjo për disa arsye: Sfida e parë lidhet me faktin e të qenit drejtuese femër në një industri që drejtohet nga meshkujt; sfida e dytë lidhet me vështirësitë e integritimit të teknologjisë me bizneset vendase, duke marrë parasysh zhvillimin teknologjik të vendit tonë dhe dëshirat e shumta të bizneseve dhe konsumatorëve, të cilët fatkeqësisht nuk shkojnë në të njëjtin drejtim; dhe sfida e tretë që do të përmendja lidhet me sjelljen konsumatore shqiptare - të qenit operatori i vetëm në treg i parasë elektronike, do të thotë që ke barrën më të madhe për të edukuar një "cash society" siç janë shqiptarët dhe për të mundësuar përfshirjen financiare.

2 - KA QENË TREGU SHQIPTAR I LEHTË PËR KETË LLOJ BIZNESI APO KA BËRË REZISTENCË?



Jemi mjaft krenarë që kemi arritur të sigurojmë një vend të fortë dhe të qëndrueshëm në tregun shqiptar për 10 vite tashmë. Në shtator, EasyPay bën plot 10 vite në tregun shqiptar. Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe operatorë të tjerë që kanë tentuar të hyjnë dhe veprojnë në këtë treg, por më pas janë tërhequr. Besimi tek ëndrra dhe dedikimi në punë i gjithë stafit të EasyPay ka bërë që të gjithë

pengesat e hasura nga të gjitha drejtimet që një biznes mund të hasë, të tejkalohen me sukses.

Pra, asnjë treg nuk është i lehtë për të hyrë, por skuadra e EasyPay deri më tani ia ka arritur që të minimizojë pengesat, duke ofruar shpeshherë "tailor made services" për t'u përshtatur me kërkesat e bizneseve e ndryshme, me synim që t'i vijë afër të gjithë grupeve të konsumatorëve në treg.

3- COVID-19 ISHTE NJË GODITJE APO NJË MUNDËSI PËR BIZNESE SI EASYPAY?

Të qenit një kompani teknologjike me staf rinor, na dha mundësinë të ishim fleksibël dhe të përshtateshim shpejt me kalimin e punës "remote" brenda 24 orëve. Puna gjatë COVID-19 u spostua nga zyra në "shtëpi" dhe stafi ynë u përball me një fluks kërkesash si nga bizneset që kërkonin të integronin butonin e EasyPay në platformat e tyre, po ashtu edhe nga individët që krijuan llogari EasyPay dhe kërkonin të paguanin online faturat e tyre. Numri i klientëve EasyPay gjatë periudhës së COVID-19 u trefishua në krahasim me muajt përpara. Pra, shumë mirë mund të themi që ishte mundësi, oportunitet dhe jo goditje. Sigurisht, patëm dhe ne luhajat tona, sidomos me rrjetin e agjentëve që janë biznese të vogla dhe i duhej ta mbyllnin biznesin për ca kohë ose të punonin në orare shumë të kufizuara.

Gjithashtu, COVID-19 pati të mirën që i tregoi biznesit në



➤ përgjithësi që digjitalizimi nuk është më një mundësi e së ardhmes, por është nevojë imediate e çdo biznesi.

4- SI PO E PËRBALLONI FLUKSIN E NEVOJAVE PËR DIGJITALIZIM NË SHUMË SEKTORË TË EKONOMISË, SIDOMOS TEK E-COMMERCE?

Mundësia që u krijua nga COVID-19 ishte e paparashikuar. Kjo na detyroi që të maksimizojmë forcat për t'u përgjigjur me fluksin e kërkesave, por njëkohësisht edhe për t'u bërë kreativë dhe për të zgjeruar portofolin e produkteve të reja. Gjithashtu, i alokuam më shumë burime (resources) kanalit digjital, për t'i dhënë sa më shumë shtytje këtij kanali dhe duke tentuar të zhvendosim fokusin nga pagesat tek rrjeti agentëve tek

pagesat nga celulari. Në ndryshim nga shumë kompani të tjera që u detyruan të shkurtojnë staf si pasojë e krizës, EasyPay e rriti stafin edhe gjatë pandemisë.

Integrimi i çdo biznesi me platformën e EasyPay është i lehtë. Megjithatë, sikurse thashë edhe më lart, stafi i EasyPay mund të përshtasë platformën me nevojat e bizneseve, për t'i ofruar gjithkujt mundësi të shumta.

Edhe në ditët që flasim, kërkesa nga biznese e operatorë të industrive të ndryshme vijnë çdo ditë dhe janë mjaft specifike. Dëshira jonë është që të ndihmojmë biznesin vendas dhe ekonominë vendase të kalojë sa më shpejt këtë situatë të vështirë, duke eksploruar çdo opsion teknologjik që ka lidhje me pagesat digjitale.

5- SI ËSHTË NJË DITË PUNE E LINDËS, KUR FILLON E MBARON AJO? SI E NDANI KOHËN MES PUNËS DHE FAMILJES SUAJ?

Sikurse e dimë, balanca mes jetës dhe punës (*work-life balance*) është një ndër sfidat globale të punonjësve në mbarë botën dhe sidomos të sipërmarrësve. Veçanërisht në kohën e karantinës që punonim nga shtëpia, dita e punës nuk kishte më kufij, siç mund të jenë në ditë normale oraret e zyrës dhe kemi punuar si skuadër deri në orët e vona të natës, çdo natë për të përballuar ngarkesën.

Kështu, dita ime nis herët përpara laptop-it dhe përfundon vonë përsëri përpara laptop-it. Preferoj në mëngjes nga shtëpia të bëj gjërat që duan qetësi dhe që kanë prioritet më të lartë, dhe më pas, vazhdoj me anën

operacionale në zyrë.

Megjithatë, gjatë gjithë këtyre viteve kam bërë maksimumin tim për të gjetur një balancë midis punës - familjes - jetës sociale. Mbi të gjitha, është shumë e rëndësishme të gesh kohë për veten, të qetësohesh dhe të mendosh strategjikisht, gjë të cilën gjatë pandemisë na u dha mundësi shumë e mirë për reflektim nga shumë pikëpamje. Po ashtu, kjo verë na gjen më shumë se kurrë pa udhëtime pune dhe shumë më afër familjes se vitet e shkuara, pasi dhe fëmijët tashmë janë kthyer nga universitetet ku studiojnë dhe është oportunitet që familjet janë më të bashkuara dhe po shpenzojnë më shumë kohë me njeri-tjetrin. Pra, çdo krizë, sikurse shihet, ka dhe oportunitetet e veta, e rëndësishme është t'i identifikosh ato dhe t'i shfrytëzosh më së miri.



LINDA SHOMO, THEMELUESE DHE CEO EASYPAY

Linda Shomo është CEO dhe themeluese e EasyPay. Linda ka rekorde të provuara në ekzekutiv dhe përvojë mbi 25 vjet në leadershipin e IT, 19 prej të cilave në sektorin financiar. Para EasyPay, Linda ka patur role menaxhuese të IT në institucione të ndryshme financiare në Shqipëri. Ajo ngriti idenë e EasyPay dhe si rezultat themeloi kompaninë në 2010 dhe është një nga gratë e pakta themeluese dhe CEO në Sektorin FinTech të Ballkanit. Disa nga çmimet për rolet kryesore të Lindës në revolucionin dixhital financiar përfshijnë 'Gruaja e vitit në TIK, 2014' e akorduar nga ICT Awards, 'Women in FinTech Powerlist 2017' e zgjedhur nga Innovate Finance, një nga 3 femrat më të mira në transferimin e parave Industry 2018 e përzgjedhur nga IMTC, "Gratë Fituese të Ndërmarrësve EY", të listuar në 4 vendet e para për çmimet për Lider të Fintech / Pagesave nga Rrjeti Evropian i Pagesave të Grave 2019; Përveç drejtimit të EasyPay, Linda është anëtare e bordit të Shoqatës Shqiptare të IT dhe Rrjetit Shqiptar të Këshillimit. Linda është gjithashtu Nënkyetare e Komitetit të Biznesit Digjital në Dhomën Amerikane të Tregtisë në Shqipëri

Ndërkohë EasyPay është FinTech kryesor në Shqipëri për mbi 9 vjet e cili është një platformë gjithëpërfshirëse e pagesave dixhitale që lejon njerëzit të bëjnë pagesa për një portofol të madh të shërbimeve lokale, duke kursyer kohë, para dhe duke zvogëluar shqetësimin. Konsumatorët mund të kreditojnë portofolin e tyre EasyPay ose pa para nga telefoni i tyre celular ose në një nga 430 agjentët e tij në të gjithë Shqipërinë. EasyPay punon me institucione të ndryshme private dhe publike për të lehtësuar jetën e njerëzve dhe për të rritur numrin e shërbimeve nga të cilat mund të përfitojnë. Partneri kryesor ndërkombëtar i EasyPay është Ria Transferimi i Parave, Operatori i tretë më i madh i Transferimit të Parave në botë. Ky partneritet ka lejuar EasyPay të ofrojë transferime më të lira parash për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme në diasporën shqiptare. EasyPay u zgjodh si një nga 3 kompanitë kryesore të FinTech në Evropë për Përfshirjen Financiare, të akorduar nga European FinTech Awards 2017 si dhe platforma më e mirë e Pagesave Dixhitale Shqipëri 2019 & 2020 nga Global Banking and Finance Review.

EASYPAY

**EASYPAY ËSHTË NJË
NGA KOMPANITË
FINTECH KRYESORE
NË SHQIPËRI QË PREJ
10 VITESH**

EasyPay ofron një platformë gjithëpërfshirëse pagesash digjitale, duke i dhënë mundësinë të gjithëve të bëjnë pagesa brenda portofolit tonë të gjerë të shërbimeve lokale, duke kursyer kohë, para dhe duke rritur rehatinë.

Klientët mund të kreditojnë llogarinë e tyre EasyPay me para në dorë tek një nga 450+ pikat tona në Shqipëri, me kartë ose direkt nga llogaria bankare. Duke ofruar alternativa të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, të gjithë njerëzit, qoftë ata pa llogari bankare ose ata që disponojnë një të tillë, kanë mundësinë që me aplikacionin EasyPay të aksesojnë shërbimet financiare digjitale dhe të bëjnë pagesa online edhe nga celulari në kohë reale. Klientët tanë gjithashtu mund të përfitojnë nga portofoli i shërbimeve tona edhe fizikisht në 450+ pika shitjeje EasyPay në Shqipëri.

EasyPay rrit çdo ditë portofolin e shërbimeve të saj, duke ofruar një gamë të gjerë pagesa utilitetesh, eventesh, tak-sash, etj. Partneri ynë më i rëndësishëm ndërkombëtar është "Ria Money Transfer", një nga tre operatorët më të mëdhenj për transfertat e parave në botë, në bashkëpunim me të cilët ofrojmë transfertat e parave nga mbarë bota.



REVISTA MONITOR

Ndonëse vetëm gjysma e dytë e marsit ishte e mbyllur për shkak të karantinimit nga Covid-19, sektori i shërbimeve ka qenë shumë i prekur, çka është reflektuar në tkurrjen e indeksit të shitjeve neto, me bazë vjetore, për shumë aktivitete. Më e thellë rënia ishte për hotelerinë, që ka reflektuar dhe pasojat e tërmetit të 26 nëntorit dhe për agjencitë e udhëtimit, të cilat ishin të parat që vuajtën tkurrjen e udhëtimeve. Sipas të dhënave të INSTAT, Tregtia me shumicë shënoi rënie të shitjeve neto në volum me 4.3% me bazë vjetore në tremujorin e parë 2020, aktiviteti në hotele ra më 9%; në bare e restorante me 4.8%; për agjencitë e udhëtimit tkurrja ishte 7.3%. Në rritje me 6.2% ishte Transporti, Magazinimi dhe Posta dhe Informacion dhe Komunikacion me 2.1%.

Efektet e plota të karantinimit pritet që të duken në treguesit e tremujorit të dytë, teksa prilli ka qenë pothuajse tërësisht i mbyllur për shumë aktivitete ndërsa një pjesë e madhe rifilluan në maj.

TREGTI ME SHUMICË DHE PAKICË, RIPARIMI I AUTOMJETEVE DHE MOTORÇIKLETAVE

Indekset e treguesve në aktivitetin Tregti, e cila përfshin tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, në tremujorin e parë 2020, paraqiten si më poshtë:

Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 4,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019.

TRANSPORT, MAGAZINIM DHE POSTË

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Postë, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Detar, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e parë 2020, paraqiten si

GODITJA E SHËRBIMEVE NGA COVID-19

MË TË PREKURAT HOTELET, AGJENCITË E UDHËTIMIT, BARET E RESTORANTET



më poshtë:

Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 6,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019;

- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 1,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019.

HOTELE

Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e parë 2020, paraqiten si më poshtë:

Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 7,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 1,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019.

BAR, RESTORANTE

Indekset e treguesve në aktivitetin Bar-Restorante, në tremujorin e parë 2020, paraqiten si më poshtë:

Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 4,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 21,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i fondit të pagave shënoi rënie 20,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019

INFORMACION DHE KOMUNIKACION

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit,

Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e parë 2020, paraqiten si më poshtë:

Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,1 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019;

- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 4,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 6,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019.

AGJENCI UDHËTIMI

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e parë 2020, paraqiten si më poshtë:

Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 7,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019;

- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 2,0%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;

- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 3,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019.